

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 04.04.2022*

04.04.2022

Ora 16:10

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, Qarku Tiranë, zotit Pandeli Sotir Majko".


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:** **S'ka**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Në seancën e sotme publike kemi vetëm një çështje në rendin e ditës, që ka të bëjë me dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Socialiste, për Qarkun Tiranë. I japim fjalën Sekretarit për të relatuar mbi projektvendimin.

Z. Y. Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend, për shkak të dorëheqjes së zotit Alqi Bllako, i zgjedhur deputet i zonës zgjedhore Qarku Tiranë, i propozuar nga Partia Socialiste. Partia Socialiste është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e datës 25 Prill 2021, me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr. 69, datë 15.02.2021. Komisioni Rregullator me vendim nr. 21 ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit 409, datë 23.06.2021, ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, për caktimin e kandidatit

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 04.04.2022*

fitues si dhe renditjen e kandidatëve, të cilët nuk kanë fituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Nga lista e Partisë Socialiste, zoti Alqi Bllako është me numrin 19, ndërsa sipas këtij vendimi me numrin 19 është zoti Pandeli Majko, pas numrit 18. Referuar nenit 11 të ligjit të dekriminalizimit, verifikimi dhe vetëdeklarimi i kushteve të dhëna në këtë ligj bëhet për çdo kandidat të listës shumëemërore, për zgjedhjet pararendëse për Kuvend, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit. Kandidati për deputet ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me ligjin për ndalim, të ligjit nr.138. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se kandidati për deputet, zoti Pandeli Majko, nuk rezulton të jetë i regjistruar në regjistër me dënim penal të formës së prerë, pra rezulton i padënuar. Verifikimet e kryera, referuar pikës 2, të nenit 5, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, për kandidatin për deputet, zoti Pandeli Majko, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e deputetit. Përsa më sipër, mandati i ndërprerë i zotit Alqi Bllako, i përket kandidatit vijues të listës shumëemërore të Partisë Socialiste të zonës zgjedhore, Qarku Tiranë, i renditur me numrin 19, zotit Pandeli Majko. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit! Atëherë bazuar në sa ju relatuat, si dhe neni 19, pika 1, shkronja “i” dhe “n”, pika 2, neni 163, pika 7, neni 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe nenit 11, të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 04.04.2022*

publike”, si dhe kreut të pestë, të vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Qarku Tiranë, zotit Pandeli Sotir Majko.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Mirë faleminderit, seanca mbyllet.

Vendim nr. 140

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

